



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 14.4. 2015, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Margarita Kadriu, deputete, Lumnije Murati-ZPRK, Xhavit Drenori-IPS Alumini Kosovë, Saniye Berisha-OSBE dhe Gurjeta Zeka-LVV.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17, 18 e 31 mars 2015;
3. Anëtarësimi i Kuvendit në organizata parlamentare;
4. Grupet e miqësisë në mes të Kuvendit të Kosovës dhe parlamenteve tjera;
5. Vizita e Komisionit jashtë vendit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17, 18 e 31 mars 2015;

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 17, 18 e 31 mars 2015.

3. Anëtarësimi i Kuvendit në organizata parlamentare;

Enver Hoxhaj lidhur me anëtarësimin e Kuvendit të Kosovës në organizata parlamentare rajonale, evropiane, e ndërkombëtare, tha se Kuvendi i Kosovës është një ndër institucionet më të izoluar që ka Kosova. Përkundër faktit se ne mund të marrim pjesë në ndonjë konferencë nuk do të thotë se jemi institucion vendimmarrës në të. I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me një studim për bashkëpunimin parlamentar, i cili tha se jep një pasqyrë mbi anëtarësimin në organizata parlamentare për Kosovën dhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi në institucione parlamentare, tha se grupohet në organizata parlamentare, në agjenci parlamentare, në organe parlamentare dhe në rrjetet e deputetëve. Duke e parë të nevojshëm anëtarësimin e Kuvendit në organizata parlamentare, Hoxhaj propozoi që Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Protokoll të dalin me një listë të plotë se ku dhe në çfarë forme duhet ne të aplikojmë për anëtarësim dhe për procedurat ligjore të anëtarësimit.

Kryetari theksoi se Komisioni po ashtu duhet ta ketë një takim të përbashkët me Kryesinë, lidhur me këtë çështje.

Ramush Haradinaj e përkrahu angazhimin për anëtarësimin e Kuvendit në organizata parlamentare dhe propozoi që kryetari i Komisionit të përfaqësoj Komisionin në takim me Kryesinë, për këtë çështje.

Blerta Deliu Kodra në diskutimin e saj, në mes tjerash theksoi se Kosova ka qenë e përfaqësuar në dy takime të Asamblesë Parlamentare të Evropës Juglindore dhe se pritet që përfundimisht në muajin maj Kosova të jetë anëtare e këtij forumi.

Puhie Demaku theksoi nevojën e ndonjë afati për hartimin e listës së organizatave ndërkombëtare, të cilat ne i synojmë, me qëllim të hartimit të ndonjë plani të veprimit në këtë drejtim.

Elmi Reçica çështjen e anëtarësimit të Kuvendit në organizata ndërkombëtare e sheh të ndërlidhur me themelimin e grupeve të miqësisë ngase përmes këtyre grupeve, tha ai, mund të arrihet deri tek informacionet më të sakta dhe më të plota, për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Enver Hoxhaj tha se sa i përket anëtarësimit në organizata parlamentare, ne duhet parë se ku qëndron interesi ynë për anëtarësim, po ashtu duhet përcjellë përvojat e vendeve të rajonit lidhur me anëtarësimin. Propozoj që deri më një maj, të dilet me një listë të plotë të informatave, lidhur me organizatat parlamentare të mundshme për aplikim, procedurën e aplikimit si dhe për kohën e aplikimit në to.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Autorizohet kryetari dhe nënkryetari i Komisionit, të takohen me Kryesinë e Kuvendit, për ta diskutuar çështjen e anëtarësimit të Kuvendit të Kosovës në organizata parlamentare.

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Protokoll e Kuvendit, deri më 1 (një) maj të hartojë një listë të plotë të organizatave parlamentare se ku dhe në çfarë forme duhet të aplikoj Kuvendi për anëtarësim dhe për procedurat ligjore të anëtarësimit.

4. Grupet e miqësisë në mes të Kuvendit të Kosovës dhe parlamenteve tjera;

Enver Hoxhaj i njoftoi anëtarët e Komisionit se Bullgaria e ka formuar grupin e miqësisë me Kosovën dhe shtoi se tek ne ende nuk janë formuar grupet e miqësisë edhe pse Komisioni ka propozuar formimin e tyre. Hoxhaj kërkoi nga z. Ismet Beqiri, kryetar i GP/LDK-së, që në mbledhjen e Kryesisë ta inicioj çështjen e konstituimit të grupeve të miqësisë.

Lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, diskutuan deputetët Zafir Berisha, Ramush Haradinaj, Margarita Kadriu, Enver Hoxhaj e Elmi Reçica, të cilët theksuan të domosdoshme, që të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit, të përshpejtohet procedura e formimit të grupeve të miqësisë, në mënyrë që ato të formohen deri në fund të muajit prill, e po ashtu edhe z. Ismet Beqiri ta ngritë këtë çështje në Kryesi.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që të përshpejtohet procedura e formimit të grupeve të miqësisë, në mënyrë që ato të formohen deri në fund të muajit prill.

5. Vizita e Komisionit jashtë vendit;

Enver Hoxhaj në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, tha se kemi një listë të gjatë të vendeve të cilat na presin për vizitë. Ai propozoi realizimin edhe të tri vizitave gjatë këtij sesioni. Sa i përket vizitës në Çeki, kryetari theksoi se kryesues i delegacionit të përbërë nga deputetët Qerim Bajrami, Ismet Beqiri, Blerta Deliu -Kodra, Zafir Berisha, do jetë Ismet Beqiri, ndërsa vizita bëhet më 27-29 prill 2015.

Kryetari njoftoi se nga Shqipëria kemi marrë përgjigje pozitive lidhur me kërkesën e Komisionit për vizitë zyrtare njëditore në Shqipëri.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, lidhur me vizitën zyrtare në Shqipëri, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të realizohet vizita zyrtare njëditore e Komisionit, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë më 20 -21 prill 2015.

6. Të ndryshme.

Ramush Haradinaj propozoi që të kërkohet nga MPJ-ja plani rreth angazhimit për njohjet dhe për anëtarësimin në organizata parlamentare, në mënyrë që të koordinohemi, ndërsa edhe Komisioni të bëhet pjesë e asaj pune.

Puhie Demaku njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me takimin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe

konsullore. Në emër të grupit të punës propozoi të bëhen vizita zyrtare mbi zbatimin e ligjit në konsullatat tona në Gjermani dhe në Zvicër.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të realizohet vizita zyrtare e anëtarëve të grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore, në konsullatat tona në Gjermani dhe në Zvicër.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me nevojën e raportimit në Komision të ministrit të MPJ-së, ministrit të MIE-së dhe ministrit të MZHE-së. Në propozim të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të ftohet për raportim në Komision ministri i MPJ-së, lidhur me punën dhe prioritetet e politikës së jashtme, çështjen e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës si dhe për tema të tjera.

Të kërkohet nga MPJ-ja, plani i saj rreth angazhimit për njohjet dhe për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata parlamentare.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj